

LIGJI Nr. 03/L-238

PËR ASPEKTET CIVILE TË RRËMBIMIT NDËRKOMBËTAR TË FËMIJËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR ASPEKTET CIVILE TË RRËMBIMIT NDËRKOMBËTAR TË FËMIJËS

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është, sigurimi i kthimit të shpejtë të fëmijës që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin e vendqëndrimit, si dhe sigurimi i respektimit i të drejtës së kujdestarisë dhe të kontaktit me fëmijët, të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës apo të një shteti kërkues.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

- 1.1. **Fëmijë** - personi nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç;
- 1.2. **Konventa e Hagës** – Konventa për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, e cila është nënshkruar në Hagë më 25 tetor 1980;
- 1.3. **Shteti kërkues** - shteti i cili është palë sipas Konventës së Hagës;
- 1.4. **Autoriteti Qendror i Kosovës** - Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës;
- 1.5. **Të drejtat e kujdestarisë** - të drejtat që lidhen me kujdesin e fëmijës dhe në veçanti, e drejta për të përcaktuar vendbanimin e fëmijës;
- 1.6. **Të drejtat e kontaktit** - të drejtat për të marrë fëmijën për një periudhë të kufizuar në një vend tjetër nga vendbanimi i tij i përhershëm;
- 1.7. **Kujdestar i përkohshëm** - personi i cili e ka larguar fëmijën pa të drejtë ose personit të cilit i është besuar fëmija në Kosovë, siç është përcaktuar me këtë ligj;
- 1.8. **Gjykata e Qarkut në Prishtinë** - gjykata kompetente për vendosje dhe pasardhësen e saj sipas Ligjit për Gjykatat.

Neni 3 Largimi apo mbajtja e padrejtë e fëmijës

1. Largimi apo mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë në rastet kur:

- 1.1. konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë bashkërisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes;
 - 1.2. në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë bashkërisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes.
2. Të drejtat e kujdestarisë, të përmendura në paragrafin 1., nën-paragrafin 1.1., të këtij neni, mund të burojnë nga ligji, vendimi gjyqësor apo administrativ ose të një marrëveshjeje që ka efekt ligjor sipas ligjit të shtetit.
 3. Në përcaktimin nëse largimi apo mbajtja e fëmijës ka qenë e padrejtë autoritetet kosovare mund t'i referohen ligjit apo vendimit të huaj *ex-officio*.

Neni 4 **Roli i Autoritetit Qendror të Kosovës**

1. Ministria e Drejtësisë është Autoriteti Qendror në Kosovë, për të kryer detyrat e përcaktuara me këtë ligj.
2. Ministria e Drejtësisë bashkëpunon me autoritetet qendrore të caktuara në shtetet tjera dhe nxit bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente në Kosovë, për të siguruar kthimin e shpejtë të fëmijëve duke përfshirë masat:
 - 2.1. për të zbuluar vendndodhjen e fëmijës, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë;
 - 2.2. për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijën nga veprimet e dëmshme duke marrë ose bërë që të merren masa të përkohshme;
 - 2.3. për të siguruar kthimin vullnetar të fëmijës ose për të arritur një marrëveshje për çështjen;
 - 2.4. për të filluar apo lehtësuar institucionit procedimin gjyqësor ose administrativ, me qëllim të kthimit të fëmijës dhe në rastin e duhur, të bëjnë përgatitje për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit;
 - 2.5. siç e kërkojnë rrethanat, të sigurojnë ose lehtësojnë sigurimin e konsulencës dhe asistencës ligjore, duke përfshirë pjesëmarrjen e konsulentëve ligjorë;
 - 2.6. të marrin masat e nevojshme administrative, për të siguruar kthimin e sigurt të fëmijës;
 - 2.7. të shkëmbejë informata me autoritetet qendrore të shteteve tjera për eliminim e pengesave për zbatimin e këtij ligji.

Neni 5 **Raportimet**

1. Për të siguruar informacione lidhur me fëmijën, Ministria e Drejtësisë mund të kërkojë:
 - 1.1. nga cilido autoritet publik apo person në Kosovë, të sigurojë raport me shkrim apo informacione në lidhje me vendndodhjen e fëmijës;
 - 1.2. nga cilido gjykatë në Kosovë që të sigurojë kopje të vërtetuara të çfarëdo urdhri të gjykatës përkatëse, aktvendimi apo dokumentacion në lidhje me fëmijën.

KREU II **PROCEDIMET E PËRGJITHSHME**

Neni 6 **Kërkesa për kontakt dhe kthimin e fëmijës**

1. Çdo person, institucion apo organ tjetër që pretendon se një fëmijë është larguar nga apo në Kosovë apo është mbajtur në kundërshtim me të drejtat e kujdestarisë, mund t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë ose Autoritetit Qendror të ndonjë shteti tjetër për asistencë në sigurimin e kthimit të fëmijës.

2. Kërkesa për kthimin e fëmijës në Kosovë, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, mund t'i dorëzohet gjithashtu edhe Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

3. Gjykata e Qarkut në Prishtinë do t'i transmetojë kërkesën Ministrisë së Drejtësisë me kusht që kërkesa të plotësojë kushtet në vijim:

3.1. informacion në lidhje me identitetin e kërkuesit, të fëmijës dhe të personit që supozohet se ka larguar apo mbajtur fëmijën pa të drejtë;

3.2. data e lindjes së fëmijës;

3.3. shkaqet mbi të cilat bazohet pretendimi i kërkuesit për kthimin e fëmijës;

3.4. të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me vendndodhjen e fëmijës dhe identitetin e personit me të cilin supozohet të jetë fëmija.

4. Kërkesës për kthimin e fëmijës në Kosovë duhet t'i bashkëngjitet:

4.1. një kopje e vërtetuar e ndonjë vendimi apo marrëveshjeje përkatëse;

4.2. certifikatë apo dokument i vërtetuar që vjen nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër kompetent i shtetit të vendbanimit të përhershëm të fëmijës ose nga një person i kualifikuar, në lidhje me ligjin përkatës të këtij shteti;

4.3. çdo dokument tjetër në interes të çështjes.

Neni 7 Procedurat e kthimit vullnetar

1. Me pranimin e kërkesës nga vendi i huaj dhe pas verifikimit se kërkesa është në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë do të informojë kujdestarin e përkohshëm të fëmijës se larguar apo mbajtur padrejtësisht në lidhje me kërkesën dhe do të bëjë propozimin për të siguruar kthimin vullnetar të fëmijës ose për të arritur marrëveshje.

2. Nëse kujdestari i përkohshëm nuk ndërmerr veprime brenda shtatë (7) ditëve prej datës kur e ka pranuar shkresën, Ministria e Drejtësisë inicion procedurat gjyqësore në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe është e autorizuar të veprojë në interes të kërkuesit për kthimin e fëmijës nga Kosova.

3. Nëse Ministria e Drejtësisë, pranon kërkesën për kthimin e fëmijës nga Kosova dhe ka arsye të besojë se fëmija është në një shtet tjetër, do t'ia transmetojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa vonesë kërkesën autoritetit qendror të këtij shteti dhe do të informojë autoritetin qendror kërkues ose kërkuesi, në varësi të çështjes.

KREU III PROCEDURAT GJYQËSORE

Neni 8 Juridiksioni i Gjykatës

1. Gjykata e Qarkut në Prishtinë do të ketë juridiksionin ekskluziv të instancës së parë në Kosovë.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i urdhrave dhe aktvendimeve sipas këtij ligji do të procedohen në pajtim me Ligjin e Procedurës Jokontestimore.

3. Nëse Gjykata e Qarkut në Prishtinë nuk vendos brenda një periudhe prej dyzetedy (42) ditëve lidhur me kërkesën, nga data e pranimit të kërkesës:

3.1. Ministria e Drejtësisë mund të kërkojë nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, që të paraqet deklaratë për shkaqet e vonesës së marrjes së vendimit brenda periudhës së përcaktuar; dhe

3.2. Kryetari i Gjykatës së Qarkut do t'i jep arsyet me shkrim brenda pesë (5) ditësh pas pranimit të kërkesës nga Ministria. Me pranimin e arsyeve me shkrim, Ministria e Drejtësisë do t'ia përcjell ato kërkuarit.

4. Gjykata do t'i jep përparësi procedurës së kërkesës për kthimin e fëmijës.

5. Rishikimi i një kërkesë dhe lëshimi i urdhrave dhe aktvendimeve sipas këtij ligji do të procedohen në instancë të lartë nga një gjyqtar profesionist me ekspertizë në ligjin familjar.

6. Procedurat gjyqësore do të procedohen në pajtim me Ligjin e Procedurës Jokontestimore, nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë ligj.

7. Gjykatat duhet t'i japin përparësi procedurave të kërkesës për kthimin e fëmijës.

Neni 9 Ndikimi në procedurat tjera

Kur Gjykata e Qarkut në Prishtinë e pranon një kërkesë sipas këtij ligji, procedurat në çfarëdo gjykatë tjetër në Kosovë në lidhje me çështjen e kujdestarisë së fëmijës do të ndërpriten derisa procedura për kthimin e fëmijës ka përfunduar.

Neni 10 Kompetenca e Gjykatës

1. Gjykata mund të:

1.1. urdhërojë kthimin e fëmijës në shtetin kërkuar;

1.2. të jap deklaratë që largimi ose mbajtja e fëmijës jashtë Republikës së Kosovës ka qenë i padrejtë;

1.3. të nxjerr urdhër apo vendim, sipas nevojës, në mënyrë që të vendos lidhur me largimin e padrejtë të fëmijës apo të zbatojë urdhrin e kthimit;

1.4. t'i jap urdhra kujdestarit të përkohshëm në mënyrë që të sigurohet kthimi sa më i shpejtë i fëmijës.

2. Gjykata mund të dënojë kujdestarin e përkohshëm, në rast se nuk i përmbahet urdhrin të gjykatës, me gjobë deri në dhjetëmijë (10.000) Euro për çdo shkelje të urdhrin të gjykatës.

3. Vendimi sipas këtij ligji nuk do të perjudikojë mbi thelbin e të drejtave të kujdestarisë derisa nuk të vendoset se fëmija nuk do të kthehet sipas këtij ligji ose nëse nuk bëhet një kërkesë sipas këtij ligji brenda një kohe të arsyeshme pas marrjes së njoftimit.

4. Gjykata para nxjerrjes së urdhrin për kthim, mund të kërkojë që kërkuari të merr një vendim nga autoritetet e shtetit të vendbanimit të përhershëm, se largimi apo mbajtja ishte e padrejtë, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur një vendim i tillë mund të merret në këtë shtet. Autoritetet qendrore të shteteve tjera do t'i ndihmojnë kërkuarit të marrin një vendim të tillë.

5. Nëse gjykata ka arsye të besojë se fëmija është dërguar në një shtet tjetër, do të pezullojë procedurën për kthimin e fëmijës.

Neni 11 **Urdhri për kthim**

1. Gjykata do të urdhërojë kthimin e menjëhershëm të fëmijës nga Kosova në shtetin kërkues nëse:

1.1. fëmija është larguar apo mbajtur pa të drejtë në Kosovë; dhe

1.2. nga data kur është pranuar kërkesa në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ka kaluar një periudhe me pak se një (1) vit nga data e largimit apo mbajtjes së padrejtë të fëmijës në Kosovë.

2. Gjykata do të urdhërojë kthimin e fëmijës së larguar apo mbajtur pa të drejtë edhe kur kërkesa është pranuar pas mbarimit të periudhës së një (1) viti, siç referohet në paragrafin 1. të këtij neni, për sa kohë që nuk është provuar se fëmija tashmë është përshtatur në një mjedis të ri të tij.

Neni 12 **Përfundimet e urdhrit për kthim**

1. Gjykata nuk është e detyruar të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse personi, institucioni apo organi tjetër që e kërkon kthimin e tij, konstaton që personi, institucioni apo organi tjetër që është kujdesur për fëmijën nuk po ushtronin të drejtat e kujdestarisë në kohën e largimit apo mbajtjes ose kanë rënë dakord, ose si rrjedhojë të kenë pranuar në heshtje largimin apo mbajtjen e padrejtë të fëmijës.

2. Në rrethana përjashtuese gjykata nuk është e detyruar të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse ekziston rrezik serioz që kthimi do ta ekspozojë fëmijën ndaj dëmit fizik ose psikologjik ose vënien e fëmijës para një situatë të patolerueshme.

3. Gjykata mund të refuzojë të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse gjen se fëmija kundërshton të kthehet dhe ka arritur një moshë dhe një shkallë pjekurie, sipas së cilës është në gjendje të vendosë vetë për jetën e vet.

4. Në marrjen parasysh të rrethanave që i referohen këtij neni, do të merren në konsideratë informacionet në lidhje me të kaluarën sociale të fëmijës, të siguruar nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër kompetent i vendbanimit të përhershëm të fëmijës.

5. Gjykata gjatë marrjes së vendimit në lidhje me mos kthimin e fëmijës nuk do të perjudikojë mbi thelbin e të drejtave të kujdestarisë.

Neni 13 **Përfundimi i efektit të urdhrit ekzistues të kujdestarisë**

Kur Gjykata urdhëron kthimin, çfarëdo urdhri tjetër në lidhje me të drejtat e kujdestarisë për të njëjtin fëmijë, i nxjerrë nga një gjykatë në Kosovë, nuk ka efekt.

Neni 14 **Efektet e urdhrit të kujdestarisë në Kosovë**

Vendimi në lidhje me kujdestarinë që është marrë në Kosovë, nuk është bazë për refuzim të kthimit të fëmijës sipas këtij ligji, por gjykata mund të marrë në konsideratë arsyet e këtij vendimi kur të zbatojë dispozitat e këtij ligji.

Neni 15 **Masat e përkohshme**

1. Pas kërkesës të bërë nga Ministria e Drejtësisë, ose sipas detyrës zyrtare, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, mund në çfarëdo kohe, para nxjerrjes së çfarëdo vendimi sipas këtij ligji, të caktojë masat e përkohshme, derisa i konsideron si të përshtatshme për qëllime të:

1.1. mirëqenies së fëmijës; dhe

1.2. parandalimit të ndryshimeve në rrethanat relevante për kërkesën, veçanërisht në lidhje me sigurimin e vendndodhjes së fëmijës, gjatë procedurave dhe të parandalojë pengesat e kthimit të fëmijës, duke përfshirë urdhrat në lidhje me vendbanimin e përhershëm të fëmijës, kujdesin apo arsimimin e fëmijës.

Neni 16 Zbatimi

Gjykata e Qarkut në Prishtinë do të zbatojë sipas detyrës zyrtare çfarëdo urdhri të nxjerrë sipas këtij ligji dhe do të merr çfarëdo vendimi për zbatimin e shpejtë sipas nevojës.

KREU IV TË DREJTAT E KONTAKTIT

Neni 17 Kontakti

1. Kërkesa për të marrë masa për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit, mund t'i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë ose Autoriteteve Qendrore të Shteteve tjera në të njëjtën mënyrë siç bëhet kërkesa për kthimin e fëmijës.

2. Ministria e Drejtësisë në bazë të nenit 4 të këtij ligji, do të nxis realizimin e të drejtave të kontaktit dhe plotësimin e kushteve të cilat mund të jenë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave. Ministria e Drejtësisë do të ndërmerr hapa për të shmangur, sa më shumë që të jetë e mundur, pengesat ndaj ushtrimit të këtyre të drejtave.

3. Ministria e Drejtësisë mund të iniciojë ose ndihmojë fillimin e procedimit, me qëllim të organizimit ose mbrojtjes së këtyre të drejtave dhe sigurimit e respektimit të kushteve ndaj të cilave mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave.

KREU V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 18 Gjuha e komunikimit

Kërkesa, komunikimi apo ndonjë dokument tjetër i dërguar Ministrisë së Drejtësisë do të jetë në gjuhën origjinale dhe do të shoqërohet nga një përkthim zyrtar në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 19 Shpenzimet

1. Shpenzimet e procedurave gjyqësore duke përfshirë sigurimin e ndihmës ligjore, në bazë të paragrafit 2. të këtij neni do të barten nga Buxheti i Kosovës. Nëse gjykata e qarkut nxjerr urdhër në favor të kërkuesit, ajo mund të kërkojë nga përgjegjësi që të mbulojë shpenzimet e procedurave dhe shpenzimet e kthimit të fëmijës.

2. Ndihma ligjore do t'i vihet në disponim kërkuesit dhe përgjegjësit për të mbuluar shpenzimet e përfaqësimit ligjor në bazë të kërkesës.

3. Gjykata mund të lirojë personin përgjegjës nga kompensimi i shpenzimeve të procedurës në rast së i njëjti është në gjendje të rëndë ekonomike.

Neni 20
Konventa e Hagës

Ky ligj do të interpretohet dhe zbatohet në pajtim me Konventën e Hagës si dhe me praktikat më të mira të siguruar nga Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Neni 21
Kompetencat për aktet nënligjore

Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 22
Dispozitat Kalimtare

Deri me hyrjen në fuqi të ligjit për gjykatat, gjykatë kompetente për zbatimin e këtij ligji do të jetë Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Me hyrjen në fuqi të ligjit për gjykatat, gjykatë kompetente për zbatimin e këtij ligji do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 23
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/29 për Mbrojtjen kundër Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve.

Neni 24
Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L- 238
28 tetor 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-068-2010, datë 09.11.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.